



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A nr. 540/2023

lidhur me

*diskriminimin mbi baza gjinore me rastin e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të
Radiotelevizionit të Kosovës*

Për:

Znj. Albulena Mehmeti, kryetare
Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës

Kopje:

Z. Valon Ramadani, kryetar
Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Znj. Duda Balje, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e
Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 21 tetor 2024

I. QËLLIMI I RAPORTIT

1. Ky Raport ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) përkitazi me çështjen e procedurës së përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të përgjithshëm të RTK-së dhe zbatimin e Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, lidhur me përfaqësimin e barabartë gjinor me rastin e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të RTK-së në konkursin e datës 22 nëntor 2022.

II. KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

2. Avokati i Popullit, sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Të hetojë ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.”* (neni 16, paragrafi 1).
 - *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”* (neni 18, par. 1, nënpar. 2).
 - *“Të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave.”* (neni 18, par. 1, nënpar. 4).
 - *“Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.”* (neni 18, par. 1, nënpar. 5).
 - *“T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (neni 18, par. 1, nënpar. 6).
 - *“Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.”* (neni 18, par. 1, nënpar. 7).
3. Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 13 [Avokati i Popullit], përcakton: *“Avokati i Popullit është institucion i barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.”*
4. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9 [Avokati i Popullit], paragrafi 2, nënparagrafi 2.7, përcakton se Avokati i Popullit: *“Ofron këshilla, udhëzime dhe mbështetje, subjekteve të sektorit publik dhe privat mbi praktikën e mira në promovimin e barazisë, në përshtatjen ndaj diversitetit dhe parandalimin e diskriminimit mbi bazat e mbuluara nga Ligji përkatës për Barazi Gjinore dhe nga ky Ligj, si dhe jep rekomandime për marrjen e masave për promovimin e barazisë, përshtatjen ndaj diversitetit dhe/ose luftimin e diskriminimit.”*
5. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi ligjore.

III. RRETHANAT E RASTIT

6. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 9, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, të Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, më 14 mars 2023 ka pranuar ankesën e znj. Ilire Zajmi-Rugovës (më tej në tekst: “ankuesja”), parashtruar kundër RTK-së, me pretendime për diskriminim mbi bazën gjinore me rastin e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të përgjithshëm të RTK-së.
7. Sipas pohimeve të ankueses, ajo kishte konkurruar dhe u ishte nënshtruar procedurave të intervistimit për pozitën e zëvendës drejtorit të përgjithshëm, në konkursin e datës 22 nëntor 2022.
8. Ankuesja më tej ka njoftuar se më 21 dhjetor 2022, nëpërmjet e-mailit zyrtar nga Administrata e RTK-së ishte njoftuar se në bazë të rezultatit përfundimtar ka arritur 82.6 pikë. Po ashtu është njoftuar nga Komisioni Përzgjedhës se pas kalimit të afatit të ankesave, kandidatin më të suksesshëm do t’ia propozonte drejtorit të përgjithshëm të RTK-së.
9. Më 30 dhjetor 2022, pas orarit të rregullt të punës, ajo ishte njoftuar nga Administrata e RTK-së se më 6 janar 2023 është ftuar për riintervistim nga i njëjti Komision Përzgjedhës, me tekstin e ftesës si në vijim: *“Po ju shkruajmë lidhur me konkursin publik të shpallur nga RTK më datë 22.11.2022, për pozitën e Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i RTK-së. Pas pranimit të një ankesë nga një kandidatë, Komisioni i Ankesave ka vendosur që çështjen t’ia rikthej në rivlerësim tek Komisioni Përzgjedhës.”*
10. Ankuesja ka pohuar se pas pranimit të njoftimit, ajo, më 4 janar 2023, ka dërguar një e-mail zyrtar në Administratën e RTK-së, me ç’ rast ka kërkuar t’i dërgohej Vendimi i Komisionit të Ankesave, për të kuptuar cilat janë shkaqet që çështja është kthyer në riintervistimin e kandidatëve. Ankuesja ka thënë se kërkesën e njëjtë e kishte përsëritur edhe më 5 janar 2023, por nuk e ka marrë Vendimin e protokolluar të Komisionit të Ankesave, të cilit i referohej Administrata e RTK-së në njoftimi për riintervistim, datë 30 dhjetor 2022.
11. Ankuesja më tej ka njoftuar se më 5 janar 2023, nga Administrata e RTK-së nëpërmjet e-mailit ka marrë një njoftim, ku thuhet: *“Po ju shënojmë se më datë 28.12.2022, Komisioni i Ankesave ka marrë vendim më nr. Protokollit 4625/22 që procedurat e përzgjedhjes së zv. Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së të kthehet në rishqyrtim (pas ankesës së një kandidati).”* Mirëpo, sipas ankueses, as në këtë e-mail nuk kishte të bashkëlidhur asnjë vendim të Komisionit të Ankesave.
12. Ankuesja ka njoftuar se meqenëse pas dy kërkesave zyrtare që i kishte dërguar në Administratë nuk i janë ofruar vendimet e Komisionit të Ankesave dhe as të Komisionit Përzgjedhës dhe duke e pasur të paqartë se mbi çfarë baze do të bëhej riintervistimi për pozitën e zëvendës drejtorit të RTK-së, ajo ka njoftuar Administratën se ka vendosur të mos paraqitej në riintervistimin e datës 6 janar 2023.
13. Më 11 janar 2023, ankuesja ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave kundër Vendimit të Komisionit Përzgjedhës me pretendimet se Komisioni i Ankesave nuk ka pasur bazë ligjore që ta kthente në rishqyrtim çështjen në rastin e ankuesit R. G. dhe se riintervistimi nuk është paraparë në asnjë dispozitë ligjore dhe se ndaj saj është bërë

shkelje edhe për faktin se nuk i janë ofruar dokumentet që ka kërkuar nga Departamenti i Administratës.

14. Më 13 janar 2023, Komisioni i Ankesave e ka refuzuar ankesën si të pabazuar, me arsyetimin se Komisioni i Ankesave, në bazë të nenit 26, paragrafi 3, si dhe të nenit 26, paragrafi 3, nënparagrafi 3, të Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë, ka vendosur: *“Të kthejë çështjen në rishqyrtim duke përshkruar lëshimet të cilat duhej të evitoheshin nga Komisioni Përzgjedhës.”* Po ashtu, në vendim thuhej se fakti që ankuesja nuk ka marrë pjesë në intervizitim, Komisioni i Ankesave ka vlerësuar se ankuesja ka hequr dorë vullnetarisht nga procedurat e mëtejme dhe se nuk mund ta atakonte një proces në të cilin me dëshirë është larguar, përkundër faktit se ka pasur ftesë të rregullt dhe zyrtare njëjtë si kandidatët e tjerë. Ndërsa, për sa i përket pretendimit se nuk i është ofruar Vendimi i Komisionit të Ankesave për kthimin e çështjes në rishqyrtim, Komisioni i Ankesave ka vlerësuar se ky pretendim është i pabazuar, ngase vendimi u dërgohet ankuesit, Departamentit të Administratës dhe Komisionit Përzgjedhës, sepse është i obligueshëm për t’u zbatuar.
15. Më 8 nëntor 2023, Avokati i Popullit i është drejtuar RTK-së: për të kërkuar informata se mbi çfarë baze procesi është kthyer në rishqyrtim; nëse në RTK ka pasur një praktikë të tillë ku konkurset, në rast të ankesave të suksesshme të kandidatëve të pakënaqur, ktheheshin në rishqyrtim te Komisioni Përzgjedhës për t’u eliminuar parregullsitë në proces dhe në vlerësimin e kandidatëve pa u anuluar procesi. Po ashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar informata nëse rishqyrtimi nga ana e Komisionit Përzgjedhës ka arritur t’i eliminonte parregullsitë e konkursit vetëm me rishqyrtim pa pasur nevojë anulimin e procesit.
16. Duke marrë parasysh se RTK-ja nuk ka kthyer përgjigje në kërkesën e Avokatit të Popullit të datës 8 nëntor 2023, Avokati i Popullit, më 8 shkurt 2024, i ka dërguar RTK-së një shkresë rikujtuuese lidhur me kërkesat për informata nga ana e RTK-së.
17. Më 26 shkurt 2024, RTK-ja ka kthyer përgjigje, me të cilën ka njoftuar se procesi i përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të RTK-së është kthyer në rishqyrtim në përputhje me nenin 26, paragrafi 3, nënparagrafi 3, të Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së, i cili përcakton se Komisioni i Ankesave mund: *“Të kthejë çështjen në rishqyrtim duke përshkruar lëshimet të cilat duhet të evitohen nga Komisioni Përzgjedhës.”* Më tej në përgjigje thuhej se nuk ka pasur një praktikë që çështja të kthehej në rishqyrtim te Komisioni Përzgjedhës, pasi ka pak muaj nga hyrja në fuqi e Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë. Përgjigjja më tej sqaronte se Komisioni i Ankesave për shqyrtimin e vendimit të Komisionit Përzgjedhës ka vepruar sipas ankesës së palës së pakënaqur R. G., me ç’ rast ka konstatuar shkelje, por shkelja nuk është e asaj natyre që do ta dëmtonte në tërësi procesin, prandaj ankesën e palës ankuese e ka aprovuar pjesërisht të bazuar dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim, duke i rekomanduar Komisionin Përzgjedhës që t’i evitonte shkeljet e evidentuara.
18. Për sa i përket ankesës së paraqitur nga ana e ankueses më datë 11 janar 2023, në përgjigjen e RTK-së thuhej se Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar dërgesat e ftesave të të gjithë kandidatëve për riintervistim dhe ka konstatuar që ato u janë dërguar në mënyrë të rregullt dhe se duke u bazuar në komunikimet përmes e-mailit, ka vlerësuar si heqje dorë

në mënyrë vullnetare nga ana e ankueses, nga procedurat e mëtejme që janë zhvilluar nga Komisioni Përzgjedhës dhe se ajo ka ushtruar ankesë në një proces në të cilin nuk ka marrë pjesë deri në fund, prandaj pretendimet e saj janë të pabazuara.

IV. KORNIZA LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

19. Neni 7 [Vlerat], paragrafi 2, përcakton:

“Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”

20. Neni 24 [Barazia para Ligjit]

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

21. Neni 11, paragrafi 1, pika c, përcakton:

“Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushën e zënies punë, për të siguruar, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas, të drejtat e njëjta, e sidomos: (a) Të drejtën për punë si një e drejtë e pamohueshme e të gjithë njerëzve; (b) Të drejtën për mundësi të njëjta punësimi, duke përfshirë zbatimin e kriterëve të njëjta të përzgjedhjes lidhur me zënie punë; (c) Të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës, të drejtën për ngritjen e postit të punës, për punë të qëndrueshme, për të gjitha përfitimet dhe kushtet e punës, të drejtën për përgatitje profesionale dhe rikualifikim, duke përfshirë mësimin e personave në ekonomi, ngritjen profesionale dhe kualifikimin e herëpashershëm.”

Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore

22. Ligji për Barazi Gjinore (LGjB), në nenin 5, par. 1 [Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore], përcakton:

“Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për të zbatuar masat legjislative dhe masat tjera [...]”

23. LBGj-ja, në nenin 6 [Masat e veçanta], paragrafi 8, përcakton:

“Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.”

Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi

24. Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi (LMD), neni 1, përcakton:

“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”

25. Neni 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i LMD-së përcakton:

“Diskriminimi i tërthortë konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin 1 (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme.”

26. Nenin 8 [Përgjegjësitë e institucioneve të Republikës së Kosovës] i LMD-së përcakton:

“Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit.”

IV. VLERËSIMI DHE KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

27. Avokati i Popullit, duke u nisur nga rrethanat e rastit, vlerëson se procedura e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të RTK-së është zhvilluar në atë mënyrë që lë mundësinë për të ngritur çështje substanciale përkitazi me rregullsinë e këtij procesi, për arsyt të cilat do të sqarohen në vijim.
28. Avokati i Popullit vlerëson se përkundër faktit që ka pasur një ankesë të suksesshme lidhur me shkeljet në procedurë me rastin e vlerësimit të kandidatëve, kthimi i çështjes në rishqyrtim nga ana e Komisionit të Ankesave tek i njëjti Komision Përzgjedhës, për të cilin është konstatuar se ka kryer shkelje procedurale e komprometon këtë proces e rekrutimi. Për më tepër, mos përcaktimi në mënyrë të qartë i rrethanave se cilat çështje mund t'i kthehen Komisionit Përzgjedhës për rishqyrtim lë hapësirë të gjerë diskrecionale për të dy komisionet, të cilat mund të shpijnë edhe në arbitraritet.
29. Avokati i Popullit vlerëson se me gjithë faktin që sipas nenit 26, paragrafi 3, nënparagrafi 3, të Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së, së cilës i referohet RTK-ja në përgjigjen e datës 26 shkurt 2024, i cili nen përcakton se Komisioni i Ankesave mund: *“Të kthejë çështjen në rishqyrtim duke përshkruar lëshimet të cilat duhet të evitohen nga Komisioni*

Përzgjedhës”, lëshimet kanë qenë të natyrës së tillë, të cilat nuk kanë pasur mundësi të evitoheshin me rikthimin e çështjes në rishqyrtim te Komisioni Përzgjedhës.

30. Për më tepër, Avokati Popullit vëren se në përgjigjen e RTK-së nuk është e qartë se për cilën rregullore bëhet fjalë, për shkak se nuk e tregon as numrin e protokollit të Rregullores e as datën e hyrjes në fuqi, por jep një përgjigje të përgjithshme që “*ka pak muaj nga hyrja në fuqi të kësaj rregulloreje.*”
31. Avokati i Popullit vëren se një rregullore e quajtur *Rregullorja për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së*, e datës 17.5.2022, me numër protokollit 0097/22, nuk mund të gjendet në portalin e RTK-së, por asaj Avokati i Popullit i është qasur nëpërmes linkut nga një portal.¹
32. Avokati i Popullit, për më tepër vëren se më 25 prill 2024, RTK-ja ka nxjerrë një rregullore të re, me numër protokollit 0022/24, e quajtur *Rregullore për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në RTK*, me të cilën rregullore në nenin 57, paragrafi 2, shfuqizohet Rregullorja Nr.0596/17 për Avancimin e të Punësuarve në RTK dhe Rregullorja për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm me Menaxhmentit të RTK-së. Vërehet se kjo rregullore e re i shfuqizon dy rregullore, në mesin e të cilave edhe Rregulloren për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm me Menaxhmentit të RTK-së, por që kësaj nuk i referohet me numër të protokollit, për dallim nga Rregullorja Nr.0596/17 për Avancimin e të Punësuarve në RTK, së cilës i referohet me numër protokollit.
33. Avokati i Popullit vëren se *Rregullorja për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në RTK*, e datës 25 prill 2024, që është në fuqi, në nenin 38 ka përcaktuar procedurat ankimore, megjithëse e ka ruajtur dispozitën që Komisioni i Ankesave vendos ta kthejë çështjen në rishqyrtim duke përkrahur lëshimet të cilat duhet të evitohen nga Komisioni Përzgjedhës (paragrafi 3.3), ka një avancim duke marrë parasysh se ka paraparë që Komisioni i Ankesave vendos të rekomandojë përsëritjen e konkursit (paragrafi 3.4), gjë që u mungonte rregulloreve të mëparshme. Megjithatë, Avokati i Popullit konsideron se rregullorja duhet të jetë më e qartë në përcaktimin e rrethanave për të cilat Komisioni i Ankesave e kthen çështjen në rishqyrtim.
34. Avokati i Popullit, më 15 korrik 2024, ka kërkuar nga vetë ankuesja nëse ajo ka qenë e informuar për rregulloren që ka qenë në fuqi gjatë procesit të përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të RTK-së. Ankuesja e ka përcjellë Rregulloren e datës 25.4.2024, e cila gjendet e publikuar në portalin e RTK-së, e cila aktualisht është në fuqi, por që nuk ka qenë në fuqi në periudhën e konkursit për zëvendës drejtor të përgjithshëm të RTK-së.
35. Për më tepër, as Konkursi i shpallur Nr. 2508, për pozitën zëvendës drejtor i përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës nuk përmend numër reference apo datë të hyrjes në fuqi të Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së.
36. Duke u nisur nga këto rrethana, Avokati i Popullit, më 15 gusht 2024, i ka dërguar një shkresë menaxhmentit të RTK-së, për të marrë informata nëse ndërmjet datave 17 maj 2022 dhe 25 prill 2024 është nxjerrë ndonjë rregullore tjetër që e shfuqizon Rregulloren

¹ <https://kallxo.com/lajm/CFare-permban-rregullorja-e-miraturar-nga-bordi-i-rtk-se-per-procedurat-e-zgjedhjes-e-drejtorit-te-pergjithshem/>

nr.0097/22 për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së, të datës 17 maj 2022.

37. Më 29 gusht 2024, Avokati i Popullit ka pranuar një përgjigje nga zëvendës drejtori i përgjithshëm i RTK-së, ku thuhet: “[m]ë datë 08.09.2022, Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur online, ka miratuar Plotësim/ndryshimin e Rregullores me nr. 0165/22 për Përzgjedhjen e Drejtorit të përgjithshëm dhe menaxhmentit të Lartë të RTK-së, gjegjësisht ndryshimin e neneve 5, 8,9,12, 17, 18, 19, 21,22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28, të saj. Megjithatë Rregullorja nr. 0165/22 e datës 08.09.2022 nuk është titulluar si “Plotësim/ndryshim” i Rregullores nr. 0097/22 e datës 17.05.2022, e njëjta ka përmbajtje të re dhe modifikime të Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së.” Përgjigjes i është bashkëngjitur Rregullorja nr. 0165/22 për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së, të datës 08.09.2022.”
38. Avokati i Popullit vëren se edhe në momentin e përfundimit të këtij raporti (datë 30 gusht 2024), kjo rregullore nuk gjendet e publikuar në portalin e RTK-së dhe se nuk është e qasshme për publikun.
39. Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Neni 5 [Publikimi me iniciativë të institucioneve publike], paragrafi 1, përcakton:
- “Institucionet publike detyrohen të publikojnë në mënyrë proaktive çdo dokument publik të prodhuar, të pranuar, të mbajtur apo të kontrolluar, në formë elektronike, përmes publikimit në ueb faqen zyrtare të institucioneve publike, pavarësisht kërkesës së personit për qasje.”*
- Ndërsa në paragrafin 2 përcakton:
- “Ueb faqet e institucioneve publike duhet të përmbajnë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: (2.3) legjislacionin bazë për organizimin, funksionimin dhe funksionet e institucionit përkatës.”*
40. Avokati i Popullit vlerëson se procesi i rregullt dhe i drejtë nga ana e RTK-së në rastin konkret është vënë në pyetje. Kjo jo vetëm për faktin se çështja i kthehet në rishqyrtim të njëjtit Komision Përzgjedhës, i cili me lëshimet që janë evidentuar nga Komisioni i Ankesave ka dëmtuar një proces rekrutues, por edhe për faktin se paqartësia dhe jotransparenca e rregulloreve të brendshme të punësimit ka ndikime negative të shumta në të drejtat e kandidatëve dhe punonjësve.
41. Avokati i Popullit më tej vlerëson se aspekti procedural i rekrutimit është një parakusht thelbësor për të siguruar një proces të rregullt dhe të drejtë. Kjo është e rëndësishme për të garantuar që procesi i përzgjedhjes së kandidatëve është i strukturuar, i drejtë dhe i paanshëm.
42. Ndryshimi i shpeshtë i rregulloreve të brendshme, në rastin konkret brenda një afati tremujsh, nga ndryshimi i Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së, e datës 17.05.2022, me numër protokollit 0097/22, deri në nxjerrjen e Rregullores nr. 0165/22 për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së, më datë 8.9.2022, krijon pasiguri juridike. Siguria juridike është një ndër elementet kyçe të

parimit të sundimit të ligjit. Ky parim siguron që ligjet, në këtë rast rregullat, të jenë të qarta dhe të sakta si dhe të parashikueshme.

43. Avokati i Popullit vlerëson se në rastin konkret është shkelur edhe parimi i barazisë duke marrë parasysh faktin se nga katër kandidatët, të cilët u janë nënshtruar proceduarave të rekrutimit, ankuesja ka qenë e vetmja kandidate femër.
44. Ligji për Barazi Gjinore kërkon saktësisht: “[...] *institucionet e tjera publike janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.*”; duke theksuar: “*Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legislative arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.*”
45. Të dhënat që Avokati i Popullit i ka siguruar nga RTK-ja, më 16 nëntor 2023, si pjesë e një hulumtimi gjithëpërfshirës lidhur me zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore nga ana e institucioneve publike, rezultojnë se RTK-ja nuk ka arritur ta zbatonte obligimin ligjor të përcaktuar në Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, duke siguruar përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, në të gjitha pozitat drejtuese dhe vendimmarrëse, me qëllim të përfaqësimit të barabartë gjinor.
46. Sipas të dhënave që kemi pranuar nga RTK-ja rezultojnë se në nivelin e lartë drejtues në RTK janë: 4 meshkuj e një femër; në nivelin e mesëm drejtues janë: 9 meshkuj e 7 femra; dhe në nivelin administrativ janë: 36 meshkuj dhe 29 femra.
47. Të dhënat e organeve të barazisë janë një burim thelbësor dhe i besueshëm për të identifikuar, dokumentuar dhe provuar diskriminimin gjinor. Këto të dhëna janë të rëndësishme për një sërë arsesh:
 - a. *Të dhënat e organeve të barazisë janë të rëndësishme se veçantë për identifikimin, dokumentimin dhe luftimin e diskriminimit gjinor. Ato ofrojnë evidencë të fortë, ndihmojnë në hartimin dhe vlerësimin e politikave, rrisin ndërgjegjësimin publik dhe mbështesin viktimat e diskriminimit. Në këtë mënyrë, ato luajnë një rol kyç në përparimin e barazisë gjinore dhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë.*
 - b. *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka përdorur të dhënat e organeve të barazisë në disa raste për të trajtuar dhe vendosur mbi çështjet e diskriminimit në përgjithësi (E.B. v. France-2008; R.B. v. Hungary -2021).*
 - c. *GjEDNj-ja ka vendosur parime të rëndësishme që garantojnë barazinë gjinore në të gjitha aspektet e jetës publike dhe private, duke përfshirë procedurat e rekrutimit. Gjykata ka theksuar rëndësinë e analizës së efekteve indirekte të politikave dhe praktikave, të cilat mund të jenë diskriminuese edhe nëse nuk janë drejtpërdrejt të drejtpërdrejt të qëllimshme.*

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “[...] *ka përgjegjësi të*

tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla [...]."; si dhe: "të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës." (Neni 18, paragrafi 1.7).

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Radiotelevizionit të Kosovës:

- Të bëjë plotësim-ndryshimin e Rregullores për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në RTK, në atë mënyrë që të hiqet paragrafi 3.3 i nenit 38, ku thuhet: "Ta kthejë çështjen në rishqyrtim duke përshkruar lëshimet të cilat duhet të evitohen nga Komisioni Përzgjedhës.", ose t'i përcaktojë në mënyrë të qartë rrethanat mbi bazën e të cilave çështja kthehet në rishqyrtim.
- Ta zbatojë obligimin ligjor të përcaktuar në Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, duke siguruar përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, në të gjitha pozitat drejtuese dhe vendimmarrëse, me qëllim të përfaqësimit të barabartë gjinor.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

